

## Shtatori, bie numri i udhëtarëve me tragete.

09.09.2011



Numri i udhëtarëve që nisen nga porti i Durrësit drejt Italisë gjatë ditëve të fundit ka ardhur duke rënë, megjithatë që nga fillimi i shtatorit tragetet kanë transportuar drejt Barit, Ankonës dhe Triestes afro 34 mijë udhëtare me 7.200 autovetura gjithsej.

Sipas statistikave të Autoritetit portual mbremjen e 8 shtatorit janë nisur me tragete 2.314 udhëtarë gjithsej, çka përbën numrin më të ulët që nga fillimi i fluksit të lëvizjes së udhëtarëve drejt Italisë. Tashmë numri i bashkëatdhëtarëve që kanë përfunduar pushimet pranë familjeve të tyre në vendin tonë, Kosovë dhe Maqedoni ka ardhur në rënie, në krahasim me muajin gusht.

Tragetet në nisje nuk kanë patur vonesa, jo vetëm për shkak të motit të mirë dhe detit të qetë, por edhe si pasojë e masave të marra që në fillim të sezonit turistik. Institucionet e doganës dhe policisë kufitare, në bashkëpunim me Autoritetin portual dhe Forcën e Sigurisë portuale kanë lehtësuar kalimin e shpejtë në 35 pikat e kontrollit, ndërsa kanë vënë në dispozicion dy sheshe për parkimin e autoveturave në nisje.

Që nga fillimi i këtij sezoni veror përmes portit detar të Durrësit kanë lundruar me tragete 410 mijë udhëtarë vendas dhe të huaj, me 93.500 autovetura gjithsej.

